

UDHËZIM
Nr.12, datë 30.9.2003

**MBI MENYRËN E ADMINISTRIMIT TË TABELAVE TË REZULTATEVE TË QENDRAVE
TË VOTIMIT NGA KOMISIONI ZGJEDHOR I QEVERISJES VENDORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 29 pika 1 dhe 109 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

1. Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore administron tabelat e rezultateve të qendrave të votimit dhe nxjerr në bazë të tyre rezultatin e zgjedhjeve për njësinë zgjedhore.
2. KZQV administron tabelat e rezultateve të qendrave të votimit sipas kësaj procedure:
 - a) Pasi verifikon kodet e vulave të kutisë së votimit dhe i shënon ato në procesverbal, hap kutinë e qendrës së votimit.
 - b) Verifikon nëse kutia përmban kopjen origjinale të tabelës së rezultateve të qendrës së votimit.
 - c) Nxjerr kopjen origjinale të tabelës, lexon përmbajtjen e tabelës dhe shënon rezultatet në procesverbalin e KZQV-së.
 - d) Përpara se KQV të vendosë tabelën e rezultateve të qendrës së votimit sërish në kutinë e votimit, kryetari i KZQV-së lexon edhe njëherë me zë të lartë të dhënat e tabelës. Çdo anëtar i KZQV-së mund të verifikojë tabelën e rezultateve. Miratimi i të dhënave nga anëtarët e KZQV-së shënohet në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KZQV-së.
 - e) Fut përsëri tabelën e rezultateve në kutinë e votimit dhe e mbyll kutinë e votimit me vula me kod.
3. Procedura e përcaktuar në nenin 2 të këtij udhëzimi përsëritet nga KZQV-ja për çdo kuti votimi.
4. Tabela e rezultateve e ardhur dorazi në KZQV nga çdo KQV, në zarf të posaçëm dërgohet në KQZ, së bashku me materialet e tjera zgjedhore.
5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.